



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

V E N D I M

Nr. 51, Datë 16 / 06 / 2017

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 119, datë 19.12.2016, të paraqitur nga subjekti ankues E.H, kundër F.P, Kryetar i Këshillit të Qarkut, Fier dhe B.V, Përgjegjës i Financës pranë Këshillit të Qarkut Fier, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “Çdo shkak tjetër”¹. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Sipas shpjegimeve të dhëna² në shkresat, protokolluar tek Komisioneri në datat 19.01.2017, 02.02.2017 dhe 10.02.2017, subjekti ankues deklaroi se ka shërbyer pranë Këshillit të Qarkut Fier në detyrën e Drejtorit të Programit të Zhvillimit dhe Planifikimit të Territorit që prej muajit Shkurt 2014, deri më datë 27.07.2016 dhe që prej datës 30.03.2015 ka gëzuar statusin e nëpunësit civil. Në datë 21.06.2016 është njoftuar për vendimin e Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier për suprimimin e vendit të punës për shkak të ristrukturimit të institucionit dhe më datë 27.07.2016, është njoftuar për vendimin nr.3, datë 20.07.2016 për lirim të tij nga puna. E.H pretendon se Kryetari i Këshillit të Qarkut Fier gjatë procesit të ristrukturimit ka favorizuar tre kolegë (B.V, A.M, A.C), për shkak të bindjeve të tyre politike dhe përkatësisë së tyre në subjektet politike të Partisë Socialiste dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim, ose të përkatësisë së tyre në grupimin politik “Aleanca për Shqipërinë Evropiane” ku bëjnë pjesë këto dy parti dhe E.H e ka diskriminuar për shkak të depolitizimit të tij. E.H informon se, F.P emëroi në pozicionin e

¹ Për shkak të depolitizimit të E.H.

² Me shkresën nr.1139/1, datë 27.12.2016 i është kërkuar subjektit ankues, dokumentacion dhe shpjegime shtesë.

Drejtorit të Drejtorisë Ekonomike, Programim-Zhvillimit dhe Planifikimit të Territorit, B.V³ duke e favorizuar atë për shkak se i përket subjektit politik të Partisë Socialiste që është pjesë e koalicionit me LSI-në, ku aderon F.P. E.H shpjegon se diskriminimi ndaj tij është kryer në dy raste: - Gjatë përzgjedhjes për emërim në vendet e punës të krijuara si pasojë e ristrukturimit dhe; - Në rastin e shlyerjes së pagave të prapambetura të periudhës Mars-Korrik 2016, pasi të gjithë punonjësve që qëndruan në detyrë iu shlyen pagesat e prapambetura ndërsa për E.H nuk është kryer pagesa për shkak se nuk i përket grupimit të tyre politik.

Duke mos rënë dakord me vendimin e marrë për largimin e tij nga puna, E.H i është drejtuar Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil i cili me Vendimin Nr. 119, datë 09.11.2016 ka vendosur të kërkoj nga njësia përgjegjëse e Këshillit të Qarkut Fier që për rregullimin e gjendjes së paligjshmërisë, të drejtojë procesin e anulimit nga ana e Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, të vendimit nr.3, datë 20.07.2016, “Për lirim nga detyra”, për nëpunësin E.H dhe akteve të tjera që lidhen me të.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e masave që të shuhet diskriminimi ndaj personit të tij.

Bazuar në nenin 33/4 të ligjit Nr. 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ankesa e paraqitur nga subjekti ankues, është e vlefshme nga pikëpamja formale pasi nuk ekziston asnjë nga rastet përjashtuese të parashikuara në këtë nen, që do ta bënte këtë ankesë të papranueshme. Si pasojë ankesa iu nënshtrua shqyrtimit të plotë.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

³ B.V ka qenë kandidat për Kryetar i Komunës Greshicë, Qarku Fier në zgjedhjet vendore të vitit 2011 i propozuar nga subjekti “Aleanca për të Ardhmen”.

Subjekti ankues lidhur me pretendimin e diskriminimit “për çdo shkak tjetër”, shprehet se arsyeja e diskriminimit të tij është, se ai është i depolitizuar dhe nuk aktivizohet në veprimtari politike, ndryshe nga kolegët e tjerë që janë anëtarë dhe aktivizohen në veprimtari politike.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën Nr. 1139/1, datë 27.12.2016 është kërkuar nga subjekti ankues plotësim dokumentacioni dhe kërkesë për informacion.
- Me shkresën Nr.142, datë 06.02.2017 është bërë njoftimi dhe i është kërkuar informacion subjektit, Këshilli i Qarkut Fier, në lidhje me ankesën për pretendimin për diskriminim të paraqitur nga E.H.

Me shkresën Nr. 166/1, datë 09.02.2017 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Këshilli i Qarkut Fier sqaron se: *“Nëpunësit: E.H, B.V, A.M dhe A.C kanë filluar punë në administratën e Këshillit të Qarkut Fier në vitin 2014, në kohën kur Kryetar i Këshillit të Qarkut Fier u zgjodh V.N, si përfaqësues i Partisë Socialiste. Me vendimin nr.6, datë 30.06.2016 të Këshillit të Qarkut Fier u vendos që personeli administrativ i këtij qarku nuk mund të jetë më shumë se 10 vetë. Duke iu referuar strukturës së vitit 2016, Drejtoria e Programim-Zhvillimit, Urbanistik dhe Planifikimit të Territorit është shkruar dhe është krijuar Drejtoria Ekonomike, Programim-Zhvillimit dhe Urbanistikës e përbërë nga 5 (pesë) specialistë, duke marrë në konsideratë diplomimin, profesionin dhe pozicionet e punës sipas strukturës. E.H është larguar nga puna për shkak të ristrukturimit të institucionit dhe mospërputhjes të arsimit me pozicionin e punës. E.H është diplomuar në degën gjuhë-letërsi, me profesion Mësuesi, profesion jo i përshtatshëm për asnjë nga pozicionet e punës që i përshtaten strukturës, ndërkohë që B.V është me profesion ekonomist, A.M me profesion inxhinier dhe A.C me profesion matematik-fizik. Në mbështetje të Ligjit nr. 152, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, neni 37 “Të drejtat politike”, pika 2, “Nëpunësit civilë të nivelit të lartë drejtues, nuk mund të jenë anëtarë të partive politike”, asnjë nga nëpunësit e lartpërmendur nuk është nivel drejtues, pasi i përkasin nivelit ekzekutiv dhe niveli i ulët drejtues”.*

- Me shkresën Nr.155/1, datë 16.02.2017 nga ana e Komisionerit i është kërkuar shpjegime dhe dokumentacion shtesë subjektit, Këshilli i Qarkut Fier.

Në vijim të procedurave hetimore, mbështetur në Urdhrin nr. 35, datë 15.03.2017 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, “Për kryerjen e inspektimit pranë Këshillit të Qarkut Fier”, inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë Këshillit të Qarkut, më datë 21.03.2017, për të kryer verifikimet përkatëse mbi çështjen në fjalë.

Gjatë inspektimit pranë Këshillit të Qarkut, inspektorët e KMD-s, morën takim me E.S, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Publike dhe I.B me detyrë Specialiste e Burimeve Njerëzore, Marrëdhënieve me Jashtë dhe Shërbimeve Publike.

Gjatë inspektimit I.B informoi se: *“Komisioni i Ristrukturimit i ngritur me Urdhrin nr.12, datë 17.06.2016 nuk hartoi një relacion për ristrukturimin, për arsye se një nga anëtarët e komisionit, M.M nuk zbatoi urdhrin dhe nuk dorëzoi dorëheqjen, duke bllokuar funksionimin e komisionit dhe mos hartimin e relacionit. Punonjësit A.M dhe A.C deri në datë 20.7.2016 e kanë fituar statusin e nëpunësit civil automatikisht për shkak të ligjit por të pa shoqëruar me dokument shkresor”*.

Në vijim të inspektimit, E.S, në lidhje me pagesën e E.H, informoi se, kishin dy vendime të gjykatës për masën e pagesës së E.H në vlera të ndryshme dhe i janë drejtuar gjykatës për të saktësuar vlerën e saktë të masës së shlyerjes së detyrimeve financiare. Për pjesën tjetër të stafit të Këshillit të Qarkut është kryer pagesa dhe presin vendimin e gjykatës për të kryer pagesën dhe për E.H.

Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioneri vëren se:

I. Lidhur me trajtimin ndryshe dhe të pafavorshëm të ankuesit gjatë përzgjedhjes për emërim në vendet e punës të krijuara si pasojë e ristrukturimit të institucionit.

Referuar shkresës nr.1371, datë 13.02.2014 të Këshillit të Qarkut Fier rezulton se E.H ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Fier në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Programim-Zhvillimit” që në datë 03.02.2014 dhe me aktin nr.368, datë 30.03.2015 të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, ka fituar statusin e nëpunësit civil për pozicionin Drejtor.

Këtë detyrë e ka kryer deri kur me Vendimin nr. 3, datë 20.07.2016 është liruar nga shërbimi civil si rezultat i suprimimit të vendit të punës për shkak të ristrukturimit të institucionit.

Referuar shkresës nr.865, datë 20.11.2013 të Këshillit të Qarkut Fier rezulton se B.V ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Fier në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Financës” që në datë 21.11.2013.

Referuar shkresës nr.271, datë 17.03.2014 të Këshillit të Qarkut Fier rezulton se A.C ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Fier në pozicionin, specialist pranë “Drejtorisë së Përkujdesjes Sociale” që në datë 17.03.2014.

Referuar shkresës nr.330/1, datë 31.03.2014 të Këshillit të Qarkut Fier rezulton se A.M ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Fier në pozicionin, specialist pranë “Drejtorisë së Shërbimeve Rajonale” që në datë 17.03.2014.

Referuar Vendimit nr. 37, datë 01.06.2015, rezulton se struktura organizative e administratës së Këshillit të Qarkut Fier përbëhet nga tri drejtori: Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Program Zhvillimit dhe Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve, ndërsa referuar Vendimit nr.6, datë 30.06.2016 rezulton se struktura organizative ka pësuar ndryshim me zvogëlim të numrit të punonjësve dhe të drejtorive të cilat nga tre u ristrukturuan në dy drejtori: Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Publike dhe Drejtoria Ekonomike, e Programim Zhvillimit dhe Urbanistikës.

Këshilli i Qarkut Fier në zbatim të procedurës të ristrukturimit të institucionit nxorri Urdhrin nr.12, datë 17.06.2016 në të cilin urdhëronte ngritjen e Komisionit të ristrukturimit të administratës.

Kryetari i Këshillit të Qarkut në mbështetje të nenit 50 të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, ka nxjerrë në mes të tjerave dhe aktet njoftim nr.611/4 dhe nr.611/11 datë 20.06.2016 për B.V dhe E.H me të cilët njoftonte punonjësit për suprimimin e vendeve të punës për shkak të ristrukturimit.

Në vijim, Kryetari i Këshillit të Qarkut ka nxjerrë Vendimin nr.14, datë 20.07.2016 në të cilin emëronte B.V në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë Ekonomike, e Programim Zhvillimit dhe Urbanistikës sipas vlerësimit të Komisionit të Ristrukturimit, ndërsa me Vendimin nr.3, datë 20.07.2016 ka liruar E.H nga shërbimi civil pas respektimit të procedurës një mujore të njoftimit.

Bazuar në Ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, neni 50/1, citon: “*Nëse për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, pozicioni i mëparshëm i një nëpunësi civil nuk ekziston më, ai transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori*”.

Përsa më sipër, vlerësojmë se pretendimet për trajtim të pabarabartë të E.H do krahasohen vetëm për punonjësit, B.V dhe E.H pasi vetëm këto dy punonjës ishin në pozicione pune të së njëjtës kategori.

Referuar legjislacionit të nëpunësit civil, duhet të ishte Komisioni i Ristrukturimit që duhet të bënte analizën krahasuese të pozicioneve të mbetura të punës me karakteristikat dhe kualifikimet të punonjësve ekzistues për të bërë të mundur që ti propozonte pastaj njësisë përgjegjëse, punonjësit që do mbeteshin në punë dhe ata që do të liroheshin nga puna, por në mungesë të një raporti nga ky komision për arsye të tërheqjes të një anëtari dhe bllokimit të vendimmarrjes dhe funksionimit të institucionit, drejtuesi i Këshillit të Qarkut Fier, bazuar në specifikat e vendit të punës ka emëruar B.V në pozicionin e drejtorit. Në këtë vendimmarrje drejtuesi i institucionit është bazuar në diplomimin dhe eksperiencën në punë të kandidatëve.

Referuar, Rregullores nr.10272/3, datë 05.12.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Këshillit të Qarkut Fier” vërehet se detyrat kryesore të kësaj drejtorie, janë të karakterit të planifikimit dhe hartimit të detyrave të karakterit financiar, që do të thotë se dhe profili i drejtuesit të kësaj drejtorie duhet të jetë i profilit ekonomik.

Komisioneri në analizë të dokumenteve të shqyrtuara vlerëson se Kryetari i Këshillit të Qarkut Fier është në paligjshmëri në raport me parashikimet ligjore, specifikisht në lidhje me zbatimin e nenit 50/1 të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, por nuk konstaton se ankuesi është trajtuar në mënyrë të pafavorshme për shkakun e pretenduar.

Për të vërtetuar se ndaj ankuesit ka një sjellje diskriminuese nga ana e Këshillit të Qarkut Fier, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe trajtimit të pafavorshëm të ankuesit.

Subjekti ankues lidhur me pretendimin e diskriminimit “*për çdo shkak tjetër*”, shprehet se arsyeja e diskriminimit të tij është, se ai është i depolitizuar dhe nuk aktivizohet në veprimtari politike, ndryshe nga kolegët e tjerë që janë anëtarë dhe aktivizohen në veprimtari politike.

Komisioneri thekson se, bazuar në Ligjin nr. 152, datë 30.05.2013 “Për Nëpunësin Civil” të ndryshuar, neni 37 “Të drejtat politike”, pika 2, “*Nëpunësit civilë të nivelit të lartë drejtues, nuk mund të jenë anëtarë të partive politike. Nëpunësit civilë të kategorive të tjera kanë të drejtë të jenë anëtarë të partive politike, por nuk mund të jenë anëtarë të organeve drejtuese të tyre*”, dhe si rrjedhim personat e përmendur, objekt të shqyrtimit të kësaj ankese kanë të drejtë që të ushtrojnë të drejtat e tyre politike brenda kuadrit ligjor të sipërpërmendur.

Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri duke pasur parasysh qëllimin që shërbimi civil duhet të jetë i qëndrueshëm, profesional dhe i bazuar në meritë, vlerëson se Këshilli i Qarkut Fier, duhet të veprojë në ligjshmëri duke zbatuar kërkesat e ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar.

II. Lidhur me trajtimin ndryshe të ankuesit nga Këshilli i Qarkut Fier, në rastin e mos shlyerjes së pagave të prapambetura të periudhës së punësimit Mars-Korrik 2016.

E.H, duke mos rënë dakord me vendimin e marrë për largimin e tij nga puna, në datë 26.08.2016 i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, në të cilën ka kërkuar që Këshilli i Qarkut Fier ti paguajë E.H pagat mujore dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore për periudhën 01.03.2016 deri më datë 20.07.2016. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë në përfundim të shqyrtimit të çështjes ka dalë me Vendimin nr. 1826, datë 10.11.2016 në të cilën ka vendosur: Detyrimin e Këshillit të Qarkut Fier të paguajë në favor të E.H, pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për muajt Mars, Prill, Maj, Qershor dhe 20 ditë të muajit Korrik 2016 si dhe dy javë leje vjetore të pa konsumuara të vitit 2016 në vlerën e një gjysmë page mujore.

Gjithashtu E.H figuron si paditës dhe pjesë e dispozitivit të Vendimit nr.2058, datë 12.12.2016 në të cilën Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë në mes personave të tjerë ka vendosur dhe për E.H për përfitimin e pagës dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore për periudhën 01.03.2016 deri në datë 20.06.2016 si dhe 15 ditë pagë për pushimet vjetore të pa marra për vitin 2016.

Ndodhur në këto kushte Këshilli i Qarkut Fier me anë të shkresës nr.202, datë 13.02.2017 i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë në të cilën ka kërkuar korrigjimin e gabimit material të vendimit pasi shtetasi E.H nuk ka qenë pjesë e padisë.

Bazuar në shkresën Urdhër-Shpenzimi nr. 21, datë 15.02.2017, Këshilli i Qarkut Fier ka shlyer detyrimet financiare për punonjësit sipas vendimit nr.2058, datë 12.12.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe është në pritje të vendimit të gjykatës për korrigjimin e gabimit material për të shlyer detyrimet financiare ndaj E.H⁴.

Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se nuk konstatohet trajtim i pabarabartë i ankuesit në raport me punonjësit e tjerë nga ana e Këshillit të Qarkut Fier në drejtim të shlyerjes së detyrimit financiar ndaj ankuesit.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 2, 3/1, neni 7/1, nenin 32, pika 1/a), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetasit E.H, nga ana e Këshillit të Qarkut Fier, në fushën e punësimit.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

⁴ Referuar proces verbalit të inspektimit datë 21.03.2017.